



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2023:251222

Datë: 06.02.2024

Numri i dokumentit: 05291873

**2023:257812**

### NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ-DEGA KAÇANIK**, Departamenti I Përgjithshëm-Divizioni Penal, Gjyqtarja Zajrete Muhaxheri, me sekretaren juridike Indira Beqa, në çeshtjen penale ndaj të pandehurit R.E nga fsh. ..., Komuna Kaçanik, i akuzuar për veprën penale, Kanosja nga neni 181 par. 3 lidhur me par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP/II.nr.1647/23 të datës 23.11.2023, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me dt.01.02.2024, në prezencë të prokurores së shtetit, Mimoza Syla-Hyseni, të dëmtuarit dhe të pandehurit me mbrojtësin e tij me autorizim, av.N. R., me dt.06.02.2024 mori dhe shpalli, dhe të njëjtën datë përpiloi këtë:

### A K T G J Y K I M

I pandehuri R.E nga fsh. ..., Komuna Kaçanik, i lindur më dt..., nga i ati B... dhe e ëma H..., e gjinisë T..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, prind i 4 fëmijëve ka të kryer shkollën e mesme, i pa pune i gjendjes së mirë ekonomike, me nr.personal:..

### ËSHTË FAJTOR

Me datë 01.11.2023, rreth orës 16:40h, në fshatin Kaçanik i Vjetër-Kaçanik, i pandehuri me qëllim të frikësimit dhe shkaktimit të ankthit kanos të dëmtuarin personin zyrtarin R.V lidhur me punën e tij zyrtare si menaxher dhe mbikëqyrës i projektit për rregullimin e rrugës ‘’’’në fshatin Kaçaniku i Vjetër, në atë mënyrë që i pandehuri R.E me familjarët e tij të pakënaqur me mos shtrimin e rrugës deri tek shtëpia e tyre, kishin bllokuar rrugën duke penguar kompaninë ‘’’’ e cila ishte e kontraktuar për të shtruar rrugën me asfalt, ku pas ndërhyrjes së policisë i pandehuri kanos të dëmtuarin zyrtarin komunal- menaxherin e projektit me fjalët **“Këtë nuk do ta harroj kurrë dhe se një jetë e kam, por nuk do ta fali kurrë këtë që ma ke bërë”** me ç ‘rast si pasojë e këtyre fjalëve dhe veprimeve tek i dëmtuarit ka shkaktuar frikë dhe pasiguri.

Me këtë veprim, i pandehuri ka kryer veprën penale, Kanosja nga nenin 181 par 3 lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Prandaj gjykata, në bazë të nenit 2,7,38,44,69,70,71 par.1 nënpar.1.3 të KPRK-së, dhe nenit 358,359,360 dhe 364 të KPP-së, e

## G J Y K O N

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 60 ditësh, i cili konfor nenit 44 të KPRK-së, i zëvendësohet me dënim me gjobë në shumë prej 300.00€.

I pandehuri është i obliguar që dënimin me gjobë t’a paguajë pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, ne afatin prej 30 ditësh pas plotfuqishmërise së këtij aktgjykimi.

Nëse i pandehuri nuk e paguan gjobën, gjykata do t’a zëvendësoje dënimin me gjobë me dënim me burgim duke llogaritur shumën prej 20 € për çdo ditë burgimi.

Detyrohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor, të paguajë pranë kësaj gjykate, shumën prej 20.00€, ndërsa për Fondin për Kompensimin e Viktimave të Krimit shumën prej 20.00€, në afat të njëjtë me gjobën, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

I dëmtuari, R.V nga fsh...- Kaçanik, nuk ka parashtruar kërkesë pasurore juridike.

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP/II.nr.1647/23 të datës 23.11.2023 të pandehurin R.E nga fsh....-Kaçanik, e ka akuzuar për veprën penale, Kanosja nga nenin 181 par 3 lidhur me par. 1 të KPRK-së, dhe ka kërkuar që I njëjti të shpallet fajtor dhe të gjykohet sipas ligjit.

Në bazë të kësaj aktakuze, gjykata ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin fillestar me dt.01.02.2024 me të cilin rast, prokurorja e shtetit Mimoza Sylja-Hyseni, mbeti në tërësi pranë aktakuzës të parashtruar pranë kësaj gjykate, pa ndryshime dhe plotësime.

I dëmtuari në fjalën e tij deklaron se, i bashkëngjitet ndjekjes penale të prokurorisë në këtë çështje penale, me që ky ka qenë realiteti sipas tij, ndërsa nuk parashtron kërkesë pasurore juridike ndaj të pandehurit, me të cilin pas këtij rasti nuk ka patur ndonjë problem tjetër. E pranon kërkimfaljen nga ana e të pandehurit dhe dëshiron të shtojë se, në vendin e ngjarjes kishte shkuar në cilësinë e personit zyrtar dhe i duhet që të vazhdojë që të shkoj në atë vend për të vazhduar punimet dhe se nuk ka asgjë personale me të.

I pandehuri në fjalën e tij në pyetjen e gjyqtarës e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën e ngarkon akuza, dhe shton se, pavarësisht faktit që fjalët si në aktakuzë, duke patur parasysh rrethanat e rastit, kanë qenë të momentit, e ndien veten të penduar për veprimin e tij, prandaj edhe I kërkon falje të dëmtuarit në sallën e gjykimit dhe I premtos të njëjtit por edhe gjykatës se veprime të tilla nuk do të përsërisë në të ardhmen.

Prokurorja e shtetit në fjalën e saj, pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, i akuzuar për veprën penale, Kanosja nga nenin 181 par 3 lidhur me par. 1 të KPRK-së, pasi që nje pranim i tillë u bë vullnetarisht nga ana e të pandehurit si dhe është në përputhje me dispozitën e nenit 242 të KPP-së, andaj i propozon gjykatës që të bëjë pranimin e fajësisë për të pandehurin dhe t'i shqiptojë sanksion penal sipas ligjit.

Mbrojtësi i të pandehurit në fjalën e tij deklaron se, pas konsultimeve me të mbrojturin e tij, dhe pasi që të njëjti i ka sqaruar pasojat dhe benefitet e pranimit të fajësisë, i njëjti e pranoi përgjegjësinë penale të ngarkuar sipas aktakuzës së prokurorisë, dhe meqenëse ky pranim është bërë konform dispozitës ligjore të nenit 242 të KPPK-së, gjykatës i propozon që të miratohet pranimi fajësisë nga i pandehuri. Ndërsa sa i përket shqiptimit të dënimit, mbrojtësi

I propozon gjykatës që paraprakisht të merren parasysh gjitha rrethanat lehtësuese ligjore duke përfshirë, por mos u kufizuar në, rrethanën posaqërisht lehtësuese, respektivisht pranimin e fajësisë në këtë fazë të procedurës penale, bashkëpunimin e tij që nga intervistimi në stacionin policor e deri tani, faktin se është hera e parë që i pandehuri bie ndesh me ligjin, e që rrjedhimisht i njëjti nuk është recidivist, faktin tjetër se gjatë shtrimit të asfaltit e ka kuptuar gabimisht se komuna nuk po e shtron asfaltin deri në pikën ku janë bërë gryerjet, e që nga ky keq interpretim i tij ka ardhur deri te manifestimi i pakënaqësisë, duke tejkalluar edhe protestimin e lejuar lidhur me mos shtrimin e asfaltit deri në atë pjesë. Gjithashtu gjykata të merr parasysh edhe faktin se i pandehuri është në kërkim të punës në shtetit e Zvicrës, ku edhe realisht kësaj gjykate I është dorzuar kërkesa për shtyrjen e kësaj séance, pasi që i mbrojturi I tij, ka patur disa intervista pune dhe në ndërkohë pret në çdo raste që të thirret për fillimin e punës. Andaj i propozon gjykatës, që të pandehurit t'i shqiptohet një dënim sa më i butë dhe atë nën minimumin e paraparë ligjor me që plotësohen kushtet ligjore për shqiptimin e një dënimi të tillë, duke marrë parasysh edhe faktin se qëllimi i dënimit nuk është rëndimi i gjendjes psikologjike të të pandehurit por risocializimi I tij.

Gjykata ka konstatuar se janë përmbushur kushtet nga neni 242 të KPP-së, pasi që formoi bindjen se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht, se pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban akuza, se akti akuzues nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore apo gabime teknike, prandaj edhe pranoi pranimin e fajësië për të pandehurin.

Nisur nga kjo gjendje e vërtetuar në procedurë gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit manifestohen të gjitha tiparet e veprës penale, Kanosja nga neni 181 par 3 lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Me rastin e caktimit të dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese konform neni 70 të KPRK-së, kështu që si rrethanë lehtësuese gjykata mori faktin se i pandehuri e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën e ngarkon aktakuza në seancën e shqyrtimit fillestar, duke shprehur pendesë për veprimin e tij, e shprehur edhe me kërkimfaljen ndaj të dëmtuarit por dhe duke premtuar para gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsërisë veprime të tilla, pastaj faktin se, bazuar në evidencën e kësaj gjykate, I njëjti nuk evidentohet për ndonjë vepër tjetër penale apo shkelje tjetër ligjore, ndërsa rrethanë të posaçme rënduese gjykata nuk gjeti, përveq veprimeve të të pandehurit të cilat paraqesin elemente të veprës penale, për të cilën shpallur fajtor,

Andaj gjykata, për këto arsye të pandehurin R.E, i akuzuar për veprën penale, Kanosja nga nenin 181 par 3 lidhur me par. 1 të KPRK-së, e gjykoi me dënim si në dispozitiv, duke vlerësuar se dënimi i caktuar është në proporcion me veprën si dhe sjelljen e te pandehurit, dhe se dënimi i shqiptuar është adekuat me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura, personalitetin e te pandehurit, andaj edhe konsideron se ky dënim do të ndikojë pozitivisht tek i pandehuri dhe personat tjerë që të mos kryejnë vepra të tilla penale duke ngritur vetëdijësimin për respektimin e ligjit dhe se me këtë do të arrihet në tërësi qëllimi i dënimit i paraparë në nenin 38 të KPRK-së.

Vendimi për shpenzimet e procedurës është i bazuar në dispozitën e nenit 449 të KPP-së.

Vendimi për taksën në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit është marrë konform nenit 36 par.3 nënpar.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

I dëmtuari, nuk ka parashtruar kërkesë pasurore juridike.

Nga të cekurat e mësipërme u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

## **GJYKATA THEMELORE FERIZAJ**

### **DEGA KAÇANIK**

**2023: 257812 datë 06.02.2024**

Sekretarja Juridike,

Indira Beqa

Gjyqtarja,

Zajrete Muhaxheri

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mundet të ushtrohet ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.